



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

U R D H Ë R

Nr. ____ , datë ____ . ____ .2026

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT, TEMAVE DHE PERIUDHAVE TË
ZHVILLIMIT TË AKTIVITETEVE INFORMUESE DHE NDËRGJEGJËSUESE
NË FUSHËN E LOBIMIT**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”),

URDHËRON:

1. Organizimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere për lobistët, zyrtarët publikë dhe publikun e gjerë, me qëllim rritjen e njohurive për rregullat e lobimit, detyrimet ligjore dhe masat për parandalimin e ndikimeve të papërshtatshme në ushtrimin e veprimtarisë së lobimit.
2. Aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuere hartohen dhe zhvillohen në mënyrë transparente, objektive, gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese, duke garantuar trajtimin e barabartë të subjekteve të ligjit.
3. Aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuere organizohen nga Komisioneri në bashkëpunim me autoritetet publike dhe institucionet e përfshira në procese vendimmarrëse.
4. Autoritetet publike dhe institucionet e përfshira në procese vendimmarrëse bashkëpunojnë me Komisionerin për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere, si dhe sigurojnë pjesëmarrjen e punonjësve të tyre në këto veprimtari.
5. Komisioneri miraton dhe publikon, brenda datës 31 janar të çdo viti, kalendarin vjetor të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere në fushën e lobimit. Kalandari përcakton formatin, temat dhe periudhat e zhvillimit të aktiviteteve, si dhe subjektet të cilave u drejtohen ato. Kalandari vjetor përfshin aktivitete për lobistët dhe zyrtarët publikë, si dhe të paktën një aktivitet informues dhe ndërgjegjësuere për publikun e gjerë. Aktivitetet mund të zhvillohen me prezencë fizike, në format online ose në formë të kombinuar.
6. Temat e aktiviteteve të përfshira në kalendarin vjetor përcaktohen mbi bazën e një vlerësimi të nevojave për informim dhe ndërgjegjësim të lobistëve, zyrtarëve publikë

dhe publikut të gjerë, duke marrë në konsideratë edhe problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të Ligjit.

7. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet struktura përgjegjëse pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky Urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi